



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 14117/24
Kaçanik, 19.06.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 19 Qershor 2024 (E Mërkurë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 09:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arben Thaqi- OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë z.Xhelal Gashi – Drejtor QPS.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Maviqe Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VI-të (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 19 Qershor, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Rastet sociale në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Ne saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ? Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2024, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 28.05.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-11716/24.

2. Rastet sociale në komunën e Kaçanikut;

z. Xhelal Gashi : Lidhur me gjendjen në sektorin ku jemi ne po i referohemi për vitin 2024, kemi ndryshime .

Momentalisht 539 shfrytëzues, nuk është numër fiks sepse prej ditës në ditë ndryshon është një lëvizje në këtë drejtim për shkak se ka migrim të popullsisë .

Ajo çka është me e re është pilot projekti për skenën e ndihmës sociale, mundësia për me aplikua është përmes platformës eKosova, e cila na ka bërë edhe një detyrë shtesë sepse përveç kësaj palët të cilët nuk kanë njohuri, të cilët aplikojnë duhet me ardhur prapë tek ne me krye aplikacionin, por ajo çka është e mirë nëse ky pilot projekt del i suksesshëm mbetet të shihet. Gjithashtu kanë angazhuar edhe nga një praktikant nëpër qendra për pune sociale i cili ka me u marr vetëm për data bazën, për ti këshilluar palët për ato qe nuk kanë njohuri për të aplikuar përmes platformës eKosova. Unë jam ithtarë i asaj qe sa shumë të shfrytëzohen platformat elektronike, fatkeqësisht te na është pak problem për shkak nivelit edukimit në këtë drejtim , ka shumë palë qe nuk kanë mundësi me shfrytëzua këtë platformë, por ka edhe që bëjnë gabime në këtë platformë, është keq sepse nëse ti e bën një gabim nuk mundesh me përmisu dhe nuk mundesh me aplikuar dhe e kanë lanë mundësin edhe fizikisht me vazhdu. Disa zyrtar janë në trajnim për këtë pilot projekt sepse ka nevojë për njohuri edhe vet zyrtarët disa detyra të reja, jemi në zbatim të kësaj të shohim deri në fund të vitit siç po shkojnë.

znj.Arta Avdiu : Çfarë ka përparësi ky pilot projekt ?

z. Xhelal Gashi : Përparësi është mosha, më herët ka qenë limiti i moshës 5 vjeçare. Me automatizëm ka qenë dashtë me ndërprerë, tash ajo nuk është, është një formë tjetër fatkeqësisht pala ka me i dhënë të dhënat përmes e platformës, ka të drejt secili me aplikuar, pak e krijon mundësin edhe të ato qe për një kohë shkurt punojnë me pas një periudhë tre mujore testuese. Përshembull ka njeri qe ka hyr në punë një muaj ditë dhe ka dal prej punë dhe ti je detyrua me ja ndal socialin. Tash ajo nuk është d.m.th. tre muaj ditë ka mundësi me vazhdua por mbas tre muaj ndërprehet. E metë e saj për shumicën e rasteve ka me qenë mbas aplikacionit të cilën aplikon.

znj.Arta Avdiu : Vlera a ka ndryshuar apo ngelet e njëjta?

z. Xhelal Gashi : Për momentin vlera nuk ka ndryshuar, por më vonë nuk e di se si do të shkojnë.

z. Ekrem Livoreka : Deshta me pyet për këta qe marrin ndihmën sociale, a kanë të drejt edhe shtesat e fëmijëve qe i qetë qeveria a munden me i marr apo jo?

z.Xhelal Gashi : Po kanë të drejt pasi që shtesat për fëmijë në Kosovë, tani janë të pavarura nga gjendja sociale e familjes. Që nga viti 2021, Qeveria e Kosovës ka vendosur që të gjitha familjet me fëmijë të moshës 0-16 vjeç kanë të drejtë të marrin këto shtesa, pavarësisht nëse një anëtar i familjes është i punësuar apo jo, ndërsa përpara ka qenë e kundërta d.m.th. nëse një anëtarë i familjes ka qenë i punësuar me automatizëm nuk i kanë takuar shtesat. Kjo gjë mund të krijojë një situatë të vështirë për sistemin në përgjithësi sepse shumë punëtorë kanë të drejtë të aplikojnë dhe kjo do të ndikojë qe numri i shfrytëzuesve do te rritet bukur shumë dhe mund të sjellë sfida të reja.

znj.Arta Avdiu : Rastet e dhunës në familje kemi pas një rënie deri në këtë muaj. Deshta me ditë, a keni me bë ndonjë gjë për qendër strehimore sepse nëse kemi ndonjë rastë dhunë në familje, ato persona ku po përfundojnë dhe ne si komunë a kemi qendër strehimore.

z. Xhelal Gashi : Ne si komunë strehimore nuk kemi pas kurrë, e kemi strehimoren regjionale ku i orientojmë palët deri tani i ka plotësua nevojat tona. Mirëpo ta kishim pas një qendër në komunën tone normalisht se do të ishte më mirë, mirëpo është problem se ki raste që nuk ke asnjë raste duhet me financu atë, kështu që nganjëherë është më mirë këtë formë qysh është s'paku të participonë si Kuvend Komunal, një pjesë dhe e dinë që e ke një strehimore dikun sepse ndodh që gjashtë muaj ditë e ki një raste por ka raste që ke edhe brenda javës 10 raste, me i pas strehimoret e tona është më mirë por duhet me mirëmbajt me financua ajo kushton shumë. Politikat sociale që bëjnë bazë statistikave këta duhet me ditë sa strehimore vyen dhe ku vyen , strehimoret nuk janë publike janë OJQ por që janë në mbikëqyrjen e qeveris dhe institucioneve komunale, kryen shërbime aq sa kanë mundësi. Kjo nuk do të thotë këtë fazë që nuk kemi raste të dhunës në familje, ka mundësi që brenda muajit ndryshon gjendja në aspekt negativ.

znj.Lejla Çaka : Cilat kategori keni më shumë shfrytëzues të rasteve sociale?

z. Xhelal Gashi : Shfrytëzueses më shumë ka me fëmijë, por tash gati ka ardhur tu nivelizu, për shkak se ka rënë numri dhe interesimi i familjeve, për me pas fëmijë po e shoh se nuk është sikur më përpara.

znj.Arta Avdiu : Nuk po e di saktë se a merret qendra për punë sociale sidomos këtë muaj të verës, po rritet numri i fëmijëve që po kërkojnë lëmosh. A keni bërë ndonjë identifikim se a janë këto fëmijë të komunës tonë dhe sa është numri i këtyre dhe a merret qendra për punë sociale me këto raste.

z. Xhelal Gashi : Çdo rast që i referohet përmes organeve të shtetit vjen tek na, ato që nuk referohen, ne nuk merremi por nga ajo që shihet ne jemi vendas fëmijë të komunës Kaçanikut nuk ka ndërsa të rajoneve tjera sipas informacioneve policisë shpesh dhe i kanë përzënë, por ato prapë po vijnë është dukuri shqetësues është në krejt Kosovën, është problem me luftu sidomos kjo pjesa e Kukësit ata janë shumë të organizuar.

znj.Arta Avdiu : Cilat janë kriteret për me adaptua një fëmijë dhe a janë rritë kërkesat në komunën e Kaçanikut.

z. Xhelal Gashi : Kërkesa ka, çështja e adaptimit është ma e komplikuar, kërkesa bëhen në qendrën për punë sociale ndërsa miratimi bëhet përmes ministrisë. Mjerisht kohëve të fundit mundësit ma pak për me bë fëmijë së paku sipas letrave të braktisur ka pak, kërkesa ka shumë pastaj janë disa kriteret kur ta kalon një moshë duhet me hejë dhe nga lista sepse nuk ke drejt me mbajt në listë. Nëse adaptuesi e kalon moshën mbi 50 vjeçare nuk e referon ligji , interesim ka dhe nuk besoj që ka kërkesë ma fisnike se sa një familje me adaptua një fëmijë, për mua vepër ma të mirë nuk besoj që ka në jetë.

znj.Arta Avdiu : Ju si qendër për punë sociale, a mundeni me ndikuar për ndonjë lehtësim në kritere?

z. Xhelal Gashi : Jo ne nuk mundemi me ndikuar në lehtësimin e kritereve sepse kriteret janë me ligj dhe ne duhet vetëm me i zbatua.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 10:13.

**Procesmbajtësja
Mavije Murseli**



**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**

